



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**BASHKIA MAT
KRYETARI**

Nr. _____ Prot.

Burrel, më _____.2023

FORMULARI I NJOFTIMIT TË FITUESIT
(NË PËRFUNDIM TË AFATEVE TË ANKIMIT)

Drejtuar: Operatorit Ekonomik: “ERALD-G” Sh.p.k., me numër Nipt-i: K36306784K, me seli: Dibër, Peshkopi, Herbel, Ndërtesa private Nr.61.

Procedura e prokurimit: “E Hapur e Thjeshtuar - Shërbime”, prokurim elektronik

Numri i referencës së procedurës: REF-57483-01-30-2023

Përshkrim i shkurtër i kontratës: “Loti Nr. 6: “Mbikqyrje të punimeve për investimin me objekt: “Rikonstruksion i Tregut Industrial Burrel”, me fond limit në vlerën: 68 093.12 (gjashtëdhjetë e tetë mijë e nëntëdhjetë e tre pikë dymbëdhjetë) lekë pa TVSH, nga të ardhurat, me afat realizimi: 2 (dy) muaj nga data e dorëzimit të sheshit të ndërtimit (i njëjtë me afatin e realizimit të punimeve nga shoqëria ndërtimore e cila do të zbatojë punimet).

Publikime të mëparshme: nuk ka patur

Buletini i Njoftimeve Publike: Nr. 12, datë 6 Shkurt 2023

Kriteret e përzgjedhjes së fituesit:

oferta ekonomikisht më e favorshme bazuar në kosto

oferta ekonomikisht më e favorshme bazuar në çmim

Me anë të kësaj ju informojmë se Ofertuesit e mëposhtëm kanë marrë pjesë në këtë procedurë me këto vlera përkatëse të ofruara:

1. Operatori Ekonomik: “MIKI CONSULTING” Sh.p.k., me numër Nipt-i: K87628701K.

Vlera: 56 321.42 (pesëdhjetë e gjashtë mijë e treqind e njëzet e një pikë dyzet e dy) lekë pa TVSH

2. Operatori Ekonomik: “ERALD-G” Sh.p.k., me numër Nipt-i: K36306784K.

Vlera: 54 831 (pesëdhjetë e katër mijë e tetëqind e tridhjetë e një) lekë pa TVSH

Janë skualifikuar Ofertuesit e mëposhtëm:

1. Operatori Ekonomik: “MIKI CONSULTING” Sh.p.k., me numër Nipt-i: K87628701K.

Përkatësisht për arsyet e mëposhtme:

❖ Nga shqyrtimi i dokumentacionit të paraqitur nga Operatori Ekonomik, shoqëria “MIKI CONSULTING” Sh.p.k., për pjesëmarrje në tender, rezulton se nuk përmbush të gjithë dokumentacionin e kërkuar në përputhje me Kriteret e Veçanta të Përzgjedhjes/ Kualifikimit, si më poshtë:

I. Nuk është përmbushur përcaktimi i pikës 2.3.5/ 2.3 Kapaciteti teknik/ 2. Kriteret e Veçanta të Kualifikimit:

2.3.5 *Operatorët ekonomik pjesëmarrës duhet të kenë në liçencë të shoqërisë e të punësuar në stafin e tij teknik për kryerjen e të gjitha shërbimeve në këtë objekt, të vërtetuar me kontratë pune (të vlefshme), diplomë përkatëse, CV, si dhe të figurojë detyrimisht në listpagesat e shoqërisë për periudhën e kërkuar në pikën 2.3.4, staf i inxhinierik si më poshtë:*

- *Minimuni 1 (një) Inxhinier Ndërtimi*

Disponimi i stafit inxhinierik do të deklarohet në seksionin përkatës të Formularit Përmbledhës të Vetëdeklarimit sipas shtojcës 9 në DST, si dhe në rast se kualifikohet, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit duhet të paraqesë dokumentacionin e kërkuar më lart.

➤ **Ky kusht nuk përmbushet nga ana e operatorit ekonomik, pasi bazuar në dokumentacionin e paraqitur, konstatohet se nuk ka përcaktuar të dhënat e Inxhinierit të Ndërtimit në seksionin përkatës të Formularit Përmbledhës të Vetëdeklarimit sipas Shtojcës 9.**

II. Nuk është përmbushur përcaktimi i pikës 2.3.7/ 2.3 Kapaciteti teknik/ 2. Kriteret e Veçanta të Kualifikimit:

2.3.7 *Operatori Ekonomik krahas Formularit të Ofertës, duhet të paraqesë dhe Analizën e përllogaritjes së ofertës, në respektim të Vendimit të Këshillit të Ministrave me Nr.354, datë 11.05.2016 të Këshillit të Ministrave “Për miratimin e manualit të tarifave për shërbime në planifikim territorit, projektim, mbikqyerje dhe Kolaudim”, si dhe shkresës Nr.Prot.5585, datë 25.07.2017 “Rekomandim mbi mënyrën e përcaktimit të tarifave minimale të specifikuara në Vendimin e Këshillit të Ministrave Nr. 354, datë 11.05.2016 “Për miratimin e manualit të tarifave për shërbime në planifikim territorit, projektim, mbikqyerje dhe Kolaudim”. Mosdorëzimi i Formularit të Ofertës së bashku me analizën e përllogaritjes sipas përcaktimeve të VKM-së Nr.354, datë 11.05.2016, është kusht për s’kualifikim.*

➤ **Ky kusht nuk përmbushet nga ana e operatorit ekonomik, pasi bazuar në dokumentacionin e paraqitur, konstatohet se nuk është paraqitur Analiza e përllogaritjes**

së ofertës në respektim të VKM-së Nr.354, datë 11.05.2016, e cila është kusht për s'kualifikim.

* * *

Duke iu referuar procedurës së lartpërmendur, informojmë Operatorin Ekonomik: “**ERALD-G**” Sh.p.k., me seli: *Dibër, Peshkopi, Herbel, Ndërtesa private Nr.61*, me numër Nipt-i: **K36306784K**, se oferta e paraqitur, me një vlerë të përgjithshme prej: **54 831** (*pesëdhjetë e katër mijë e tetëqind e tridhjetë e një*) **lekë pa TVSH, është identifikuar si oferta e suksesshme.**

Rrjedhimisht, jeni i lutur të paraqisni pranë [Bashkisë Mat/ Sektorit Juridik dhe Prokurimeve Publike, me adresë: *Sheshi “Kastriotët”, Nr.1, KP 8001, Burrel*] sigurimin e kontratës, siç parashikohet në dokumentat e tenderit, brenda **10 (dhjetë) ditëve** nga dita e marrjes/publikimit të këtij njoftimi.

Në rast se, nuk pajtoheni me këtë kërkesë, ose nuk dorëzon sigurimin e kontratës brenda afatit përfundimtar tërhiqeni nga nënshkrimi i kontratës, do të konfiskohet sigurimi i ofertës suaj, dhe do të procedohet konform dispozitave ligjore në fuqi të parashikuara nga Ligjit nr. 162/2020 “*Për prokurimin publik*”.

Ankesa pas Njoftimit të Fituesit (Paraparak)

PO JO

Nëse Po (*vendimi përfundimtar për trajtimin e ankesës/ave nr. datë*)_____

Titullari i Autoritetit Kontraktor